

V E N D I M
Nr.309, datë 21.6.1993

**PËR SHPËRBLIMIN E CILËSISË ARTISTIKE NË LETËRSI, ARTIN FIGURATIV,
MUZIKOR, KINEMATOGRAFIK, EKZEKUTIV, INTERPRETATIV, PUBLICISTIK, SI
DHE PËR KONTRIBUTIN E ANGAZHIMIT TË PËRKOHSHËM NË PROJEKTET
KULTURORE**

Me propozimin e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Të shpërblehet cilësia e krijimtarisë, ekzekutimit dhe interpretimit artistik në fushat e letërsisë, arteve figurative, muzikore, skenike, kinematografike e publicistike, si dhe për kontributin e angazhimit të përkohshëm në projektet kulturore.

Shpërblimi i mësipërm paguhet vetëm një herë.

2. Mënyra e shpërblimit dhe fondet financiare për realizimin e këtij shpërblimi do të mbështeten në vartësi të specifikave e profileve që kanë institucionet e këtij sistemi.

3. Mënyra e shpërblimit do të jetë:

a) Sipas kontratës së lidhur ndërmjet palëve, duke u mbështetur në fondet financiare të krijuara për këtë qëllim.

b) Sipas sistemit tarifar që i bashkëngjitet këtij vendimi, në lidhjet 1,2, 3, 4, 5, 6 e 7.

Pagesat e kryera sipas sistemit tarifar do të indeksohen në raport me rritjen e pagave nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

c) Për tituj që nuk përfshihen në këto lidhje dhe që gjenden në vendimin nr.550, datë 11.12.1992, shpërblimi të bëhet sipas këtij vendimi.

Në raste të veçanta, kur lind nevoja për shpërblimin e zërave të ngjashëm që nuk i përmban sistemi tarifar ky shpërblim caktohet nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe të Ekonomisë.

4. Fondet financiare krijohen nga:

a) Fondet e miratuara në buxhetin e çdo institucioni.

b) Nga përdorimi për këtë qëllim i 40 për qind të fitimit të realizuar nga shërbimet ose veprimtaritë që ofrohen për të tretë në të gjitha institucionet buxhetore të këtij sistemi.

c) Nga përdorimi për këtë qëllim i 90 për qind të fitimit të realizuar nga shitja e biletave dhe regjistrimet televizive për institucionet skenike.

ç) Nga përdorimi për këtë qëllim i 90 për qind të fitimit të realizuar nga shitja e biletave në qarkullimin e parë të filmit, duke përjashtuar fitimin e kinemave në bazë të kontratës.

d) 90 për qind e fitimit të realizuar nga qiraja e dhënies së filmit në televizion.

dh) 100 për qind e fitimit të realizuar nga çdo shitje licence jashtë shtetit për artistët kryesorë të secilit film.

e) Nga fondet financiare të akumuluar prej kontributit të fondacioneve dhe sponsorëve të ndryshëm.

5. Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve ka të drejtë të miratojë lidhjen e pagës së krijuesve, ekzekutuesve dhe interpretuesve artistikë me shpërblimin për cilësinë e krijimtarisë, ekzekutimit dhe interpretimit në fushat e mësipërme në dy mënyra, duke zbatuar vetëm njëren prej tyre, si më poshtë:

a) Do të jepet për çdo muaj 90 për qind e pagesës mujore, duke u plotësuar në fund të çdo tremujori, pas mbylljes së bilancit, me shtesat që vijnë nga fondet financiare të krijuara për këtë qëllim.

b) Do të jepet për çdo muaj 100 për qind e pagesës mujore, duke u plotësuar në fund të çdo tremujori, pas mbylljes së bilancit, me shtesën që vjen nga fondi i Buxhetit të Shtetit i miratuar për këtë qëllim.

6. Ngarkohet Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve që, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe të Ekonomisë, të nxjerrë udhëzimin përkatës.

7. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.12, datë 14.1.1988 "Për miratimin e rregullores "Për shpërblimin e autorëve të veprave letrare, artistike, shkencore e publicistike, si dhe të interpretuesve dhe ekzekutuesve", shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi

Lidhja 1

SISTEMI TARIFOR

ARTI SKENIK TËATRAL

1. Pjesë teatrale me shumë akte	-deri në 30000	lekë
2. Pjesë teatrale me një akt	-deri në 10000	"
3. Dramatizimi me shumë akte	-deri në 23000	"
4. Dramatizimi me një akt	-deri në 7500	"
5. Skeçe të ndryshme	-deri në 1500	"
6. Monologe, dialoge, intermexo	-deri në 600	"
7. Librete për akrobaci me një tablo	-deri në 600	"
kompozim origjinal për gjini të ndryshme, përpunim e përshtatje	-deri në 800	"
8. Numra shpejtësie për prestidigjatorë (për çdo numër)	-deri në 500	"
9. Pantonima	-deri në 350	"
10. Tekste konferencieri për një numër estrade	-deri në 400	"
11. Libret i plotë estrade	-deri në 20000	"
12. Pjesë për kukulla me shumë akte	-deri në 7000	"
13. Pjesë për kukulla me një akt	-deri në 5000	"
14. Dramatizim për teatro kukullash	-deri në 5000	"
15. Dramatizim për mbrëmje tematike, montazhe letraro-artistike, konkurse	-deri në 1000	"

Lidhja 2

ARTI SKENIK MUZIKOR

1. Libreti i operas me shumë akte	-deri në 25000	lekë
2. Libreti i operas me një akt	-deri në 10000	"
3. Libreti i baletit me shumë akte	-deri në 15000	"
4. Libreti i baletit me një akt	-deri në 9000	"
5. Libreti për operetë me shumë akte që vihen në skenë nga trupat profesioniste	-deri në 20000	"
6. Librete për operetë me një akt	-deri në 8000	"
7. Librete për tablo muzikore koreografike	- deri në 5000	"
8. Libreti i valleve koreografike	-deri në 1000	"
9. Libreti që punohet nga një		

vepër letraro-artistike, të shpërblehet
25% më pak se libreti origjinal.

Lidhja 3

ARTI KINEMATOGRAFIK

A. Skenar për film artistik

- | | |
|-------------------------------|--------------------|
| - Me metrazh deri në 600 m | - deri 10.000 lekë |
| - Me metrazh nga 600 - 1500 m | - deri 20.000 lekë |
| - Me metrazh mbi 1500 m | - deri 35.000 lekë |

B. Për film dokumentar

- | | |
|----------------------------|-----------------------|
| - Me metrazh deri në 500 m | - deri në 5.000 lekë |
| - Me metrazh nga 500-1000m | - deri në 10.000 lekë |
| - Me metrazh mbi 1000 m | - deri në 15.000 lekë |

C. Për film vizatimor

- | | |
|--|-----------------------|
| - Për film deri në 400 m | - deri në 10.000 lekë |
| - Kur skenari përgatitet sipas
veprave letrare të botuara,
shpërblimi për to do të jetë 25%
më pak se shpërblimi i parashikuar
për skenarin origjinal. | |

Lidhja 4

INTERPRETIMI DHE EKZEKUTIMI NË KRIJIMTARINË ARTISTIKE AMATORE

- | | |
|---|--------------------|
| 1. Këngëtar i këngës popullore,
i muzikës së lehtë | - deri në 240 lekë |
| 2. Këngëtar lirik | - deri në 260 lekë |
| 3. Orkestrant popullor,
i muzikës së lehtë | - deri në 240 lekë |
| 4. Orkestrant i orkestrës simfonike | - deri në 280 lekë |
| 5. Aktor | - deri në 300 lekë |
| 6. Figurant | - deri në 200 lekë |
| 7. Akrobat | - deri në 240 lekë |
| 8. Valltar popullor, modern,
klasik | - deri në 220 lekë |

- | | |
|--|---------------------|
| 1. Koncert i plotë i një këngëtari
popullor, i muzikës së lehtë | - deri në 1500 lekë |
| 2. Koncert i plotë i një
instrumentisti | - deri në 1200 lekë |
| 3. Koncert i plotë i dy
a më shumë këngëtarëve,
instrumentistëve, valltarëve,
për secilin | - deri në 2000 lekë |

Lidhja 5

PUBLICISTIKA

- | | |
|-------------------------|--------------------|
| a) Kryeartikulli | - deri në 600 lekë |
| b) Skica korrespondence | - deri në 300 lekë |

c) Artikull problemor, shkencor e studimor	- deri në 1500 lekë
ç) Reportazh letrar, përshkrim	- deri në 600 lekë
d) Fotoreportazhi	- deri në 600 lekë
dh) Informacioni	- deri në 200 lekë

Lidhja 6

PËRKTHIMET SHPËRBLEHEN PËR ÇDO FLETË TIPOGRAFIKE SIPAS KRITEREVE:

1. Përkthimet nga gjuha e huaj në gjuhën shqipe të materialeve të ndryshme, si leksione, artikuj e dokumente historike për përdorim të brendshëm - deri në 900 lekë
2. Përkthimet për përdorim të brendshëm nga gjuha shqipe në gjuhë të gjuhë të huaj shpërblehen deri 40 për qind më shumë se përkthimet nga gjuha e huaj në gjuhën shqipe.

Lidhja 7

KONTRIBUTI I DHËNË PËR REALIZIMIN E VEPRAVE ARTISTIKE

1. Punonjësit e tjerë që kontribuojnë me punën e tyre cilësore për realizimin e veprave të artit skenik e kinematografik brenda afateve të përcaktuara (ndriçues, marangozë, rrobaqepës, këpucarë, punëtorë skene etj.) - deri në 2 paga mujore për çdo vepër të realizuar
2. Aktorët amatorë që aktivizohen në teatrot profesioniste - deri në 300 lekë për çdo shfaqje
3. Aktorët amatorë dhe figurantët që aktivizohen në kinematografi për xhirim dhe dublime - deri në 300 lekë për ditë pune